

Shkolla e larte: Barazi hyrjeje  
Departamenti i Shkollimit dhe Shkences  
Portlaoise Road  
Tullamore  
Co. Offaly

I dashur Drejtor shkolle,

Ministri per shkollim dhe shkence, Z. Batt O' Keefe A.P. (Anetar Parlamenti), deshiron qe studentet dhe prinderit e tyre te jene ne dijeni mbi te gjitha llojet e ndihmes financiare qe eshte vene ne dispozicion te studenteve per t'i ndihmuar te vazhdojne shkollimin e metejsheem ose shkollen e larte.

Per kete qellim dua t'ju informoj mbi faqen e internetit [www.studentfinance.ie](http://www.studentfinance.ie). Kjo faqe interneti eshte zhvilluar nga Autoriteti i Shkollimit te Larte ne bashkepunim te afert me Departamentin dhe permban nje game te gjere informacioni te rendesishem ne lidhje me ndihmen financiare ne dispozicion te **te gjithë** studenteve dhe prinderve te tyre.

[www.studentfinance.ie](http://www.studentfinance.ie) eshte nje faqe udhezuese, e thjeshte per t'u kuptuar qe perfshin tarifat e kolegejeve, grantet dhe ndihmen financiare per shkollim te metejsheem dhe te larte. Informacion i qarte dhe i gjeshem eshte ofruar mbi te gjitha llojet e ndihmes financiare ne dispozicion te studenteve, duke perfshire:

- Tarifa falas
- Grante per jetesen e studenteve
- Fond per studentet me paaftesi
- Fondi i asistences studentore
- Bursa te Nivelit te Shkolles se Larte

Per me teper pergjigje per pyetje te ndryshme mbi skema dhe iniciativa jane dhene ne seksionin "Pyetjet me te shpeshta" (PMSH) te faqes se internetit. Egziston edhe nje seksion "Adresa te dobishme" qe perfshin adresat e internetit te agjensive shkollore dhe agjensi te tjera te vlefshme. Format e aplikimit do te publikohen ne kete faqe interneti kur te jene te gatshme.

Do t'ju isha mirenjohes nese do te mundesonit qe te gjithë nxenesit Maturante ne shkollen tuaj te informohen per kete faqe interneti. Gjithashtu mund te jete e vlefshme te ofroni detajet e faqes se internetit se bashku me informacionin qe jepet mbi aplikimet tek ZQA nepermjet sherbimit te Keshillimit per Karriere ne shkollen tuaj.

Sinqerisht i juaji

**Brian P. Power**  
Kryetari

*15 Janar 2010*

**Tel:** +353-57-932 5317  
**Fax:** +353-57-935 1340  
**Web:** [www.education.ie](http://www.education.ie)